

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENSINË
KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON PRIVATIZATION AGENCY
OF KOSOVO RELATED
MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU AGENCIJU ZA
PRIVATIZACIJU

C-V-13-0002

Parashtruesi i kërkesës

Ajencija Kosovare e Privatizimit,
rr. Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë
duke vepruar në cilësi të Administratorit të NSH “Trepça” nën administrimin e AKP-së

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar -V-, i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Kanev si gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, pas seancave dëgjimore dhe seancës vendimmarrëse të datës 23 prill 2013, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Kërkesa e AKP-së në cilësinë e Administratorit të Ndërmarrjeve “Trepça” për aprovimin për ngritjen e pagave për punonjësit e minierës së Stan Tërgut dhe Flotacionit Tuneli i Parë, refuzohet si e PABAZUAR.
2. Të gjitha pagesat e përfituesve të Pensionimit të Parakohshëm që paguhen nga burimet financiare të Ndërmarrjeve të Trepçës NDËRPRITEN. Të gjitha pagesat që paguhen nga burimet financiare të Ndërmarrjeve të Trepçës në emër të sistemit “Stipendi” NDËRPRITEN.
3. MIRATOHET pagesa prej 30,573.00 € si pjesë e pagave të rregullta të punëtorëve të Ndërmarrjeve tjera të Trepçës që gjenden në veri.
4. AKP, udhëzohet që të rishikoj sistemet ekzistuese të pagave të të gjitha ndërmarrjeve “Trepça” nën administrim të saj dhe të ndërmerr hapat e nevojshëm (të bëj ndryshimet e nevojshme) për të krijuar një sistem unik të pagave për të gjitha ndërmarrjet “Trepça”. Lidhur me këtë AKP duhet të paraqes raport në Dhomën e Posacme deri më 31 korrik 2013.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 15 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e Administratorit të ndërmarrjeve Trepça (më tutje AKP) ka dorëzuar në Dhomën e Posacme kërkesë për takim me kolegin për të sqaruar shumat mujore të pagave të aprovuara me aktvendimin e gjykatës nr. C-V-13-0001, datë 1 shkurt 2013.

Me 22 shkurt 2013, Dhoma e Posaçme dërgoi urdhër tek AKP-ja ku kërkoi disa sqarime dhe ndër të tjera njoftoi AKP-në se mënyra e vetme ligjore për të dëgjuar pozicionin e palës në gjykatë, éshtë nëpërmjet seancës së rregullt të shqyrtimit.

Me 1 mars 2013, AKP kërkoi zgjatjen e afatit për 15 ditë tjera për të përgatitur përgjigjet në urdhrin e lartcekur. Me 5 mars 2013, kjo kërkesë u aprovua nga Dhoma e Posaçme.

Me 21 mars 2013, në përgjigjen e saj AKP pohoi se parashtesa e dorëzuar me 15 shkurt 2013 kishte për qëllim informimin lidhur me ndryshimet në paga pas kalkulimeve për muajin Janar 2013. Më tutje AKP pohoi se shuma mujore prej 30,573.00 € për Ndërmarrjet e Trepçës që gjenden në veri éshtë stimulim që jepet në paga për shkak të cilësisë, sasisë dhe çmimit të metaleve në tregun ndërkombëtar të metaleve. Andaj toleranca éshtë 10 % në paga, por éshtë shkruar gabimisht 1 %. Sa i përket punëtorëve të ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në jug, AKP deklaroi se zyrtarët e ndërmarrjes njëanshëm (pa pëlqimin e AKP-së si Administrator) i kanë ngritur pagat e punëtorëve me 1 shkurt 2013. Ky vendim éshtë nxjerr nga ushtruesi i detyrës së Drejtorit të ndërmarrjes me efekt retroaktiv prej muajit Janar 2013 dhe ka implikime financiare prej 57,223.07 €, në muaj. Administratori nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për rritje të pagave me përjashtim të punëtorëve të minierës në Stan Tërg. Përgjigja e zyrtarëve të ndërmarrjes në sqarimet e kërkuar (nga AKP) për rritjen e pagave, ka qenë se rritja e prodhimit éshtë arsyja kryesore për rritjen e pagave. AKP ka njoftuar ndërmarrjen se kjo rritje e pagave éshtë në kundërshtim me aktvendimin e gjykatës C-V-13-0001 dhe si e tillë nuk e ka aprovimin e saj. Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me 21 mars 2013 ka anuluar vendimin e njëanshëm të zyrtarëve të ndërmarrjes për rritjen e pagave, duke lejuar rritjen vetëm për punëtorët e Minierës së Stan Tërgut dhe Flotacionit Tuneli i Parë si dhe ka vlerësuar të arsyeshme shumën mujore prej 30,573.00 €, si pjesë e pagave të rregullta për punëtorët e ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në veri.

Lidhur me pyetjet tjera të parashtruara sipas urdhrit të datës 22 shkurt 2013, AKP pohon se në nëntor 2012 punëtorët e minierës në Stan Tërg kanë kërkuar rritje të pagave prej 5 %, për shkak të rritjes së prodhimit, për çka qëndrimi i AKP-së mbetet pozitiv. Trendi i prodhimit në këtë minierë éshtë në rritje, çmimi i metaleve në tregun ndërkombëtar éshtë rritur dhe po ashtu kemi rritje të inflacionit në shportën e qytetarëve dhe rritje në shërbimet publike. Nuk ka rritje të numrit të punëtorëve. Për këto arsyë AKP pohon se duhet të lejohet rritja e pagave, pasi ndërmarrja ka fonde të mjaftueshme për ta mbuluar rritjen në fjalë dhe se fondet për mbulimin e rritjes janë ekskluzivisht të ardhura vetanake-nga shitja e koncentratit.

Me 27 mars 2013, Dhoma e Posaçme dërgoi një urdhër tjetër tek AKP, me të cilin kërkoi sqarime shtesë lidhur me sistemin e pagave në ndërmarrjen “Trepça”.

Më 11 prill 2013, u mbajt seanca dëgjimore, në të cilën AKP-ja po ashtu dorëzoi përgjigjen e saj lidhur me urdhrin e datës 27 mars.

Ndër të tjera:

Drejtori menaxhues i AKP-së pohoi se gjykata éshtë në dijeni se AKP-ja ka punuar që 8 muaj pa anëtarë të bordit. AKP-ja ka shumë probleme në veçanti me Trepçën. Kërkesa e parashtruar në gjykatë éshtë një kërkesë e Sindikatës së Stani Tërgut për të rritur pagat e punëtorëve të asaj

miniere dhe flotacionit për 10% dhe kërkesa për pagesën e 30,573.00 € për muaj, e cila shumë është paguar si shtesë për punëtorët e njësive të veriut. AKP ka gjetur të themeluar sistemin e pagave për punëtorët dhe Trepça ka menaxhmentin e saj për këto çështje. Drejtori menaxhues i ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në jug, pohoi se ka ngritje të prodhimit në minierën e Stani Tërgut dhe Flotacionit te Tuneli i Parë dhe se ne jemi duke synuar rritje të pagave në bazë të këtyre rezultateve. Zyrtari ekzekutiv i ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në veri, pohoi se nuk jemi duke kërkuar rritje të pagave.

Me kërkesë të AKP-së seanca përfundoi. Gjykata kërkoi nga AKP, që të paraqes në formë të shkruar “Skemën e Pensionimit të Parakohshëm”.

Më 15 prill 2013, vazhdoi seanca dëgjimore.

Shefi i njësisë për Riorganizim, pohoi se rritja e fundit e pagave për punëtorët e Ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në jug është bërë në mars 2012 dhe ajo ka qenë 5%. Rritja e fundit e pagave për punëtorët e Ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në veri është bërë në mars 2010, nuk më kujtohet muaji i saktë, ajo ka qenë 5%, pohoi zyrtari ekzekutiv i Ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në veri.

Drejtori menaxhues i AKP-së pohoi se, Bordi i Drejtoreve me vendimin e datës 10 prill 2013, e ka anuluar vendimin e Drejtorit të Ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në jug për rritjen e pagave. Kërkesa për rritjen e pagave ishte vetëm për punëtorët e minierës në Stari Trg dhe për punëtorët e flotacionit Tuneli i Parë.

Gjykata kërkoi nga AKP, që të paraqes jo më vonë se me 19 prill 2013, raportet mujore të prodhimit të ndërmarrjeve të Trepçës për vitet 2011 dhe 2012 me shpjegime për rritjet dhe zvogëlimet e mundshme të produktivitetit; që të sigurojë të dhëna zyrtare për kursin e inflacionit për gjysmën e dytë të vitit 2012, dhe tre muajve të parë të vitit 2013; që të sigurojë një dokument sqarues për të vërtetuar se kush duhet të jenë përfituesit e rritjes së pagave prej 10 %. Agjencia po ashtu u obligua të saktësoi se cilat sisteme të pagave janë në zbatim - sistemi në bazë të pagave për orë, apo sistemi në bazë të rezultateve të prodhimit.

Me 15 prill 2013 AKP dorëzoi parashtresën me sqarime rreth skemës së pensionimit të parakohshëm. AKP pohoi se kjo skemë e pensioneve është përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 02/2006 të MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). Sipas AKP-së, ky udhëzim kishte për qëllim sigurimin e një mirëqenie sociale më të mirë për punëtorët e Ndërmarrjeve Trepça, i cili është në zbatim prej 1 mars 2006 dhe aplikohet nga Administrata Pensionale e Kosovës. AKP deklaroi se lartësia e pensionit të parakohshëm fillimisht ka qenë 50.00 € për përfituesit-punëtorët e ndërmarrjeve Trepça dhe është paguar nga buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa nga të hyrat e ndërmarrjeve të Trepçës në këtë shumë është paguar pjesa prej 30 € për secilin punëtor. Në këtë kategori janë 2874 punëtorë të ndërmarrjeve Trepçës që gjenden në jug (dhjetor 2012) dhe 181 (dhjetor 2012) në ndërmarrjet e Trepçës që gjenden në veri.

Më tutje AKP, sqaron se kategoria tjetër e pagesave për punëtorët e ndërmarrjeve Trepça është e ashtuquajtuara *Stipendionet*. Kjo lloj pagesë prej 30 € në muaj, është më tepër një ndihmë për

punëtorët, vendet e punës së të cilëve nuk janë aktive dhe me këtë mban njëloj paqe sociale për raportet punëdhënës-punëmarrës. Përfitues të kësaj kategorie janë rrith 200 punëtorë (dhjetor 2012) të ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në Jug dhe 1873 (shkurt 2013) të ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në veri.

AKP-ja, më tutje pohon se sistemin e *Pensioneve të parakohshme* dhe të ashtuquajturave *Stipendione*, i ka gjet në zbatim nga koha e AKM-së dhe nuk e ka konsideruar të arsyeshme të ndërhyj në to, pasi këto pagesa janë simbolike dhe më tepër i ngajnjë ndihmës sociale.

Në përgjigjen e saj të dorëzuar me 19 prill 2013, AKP-ja ndër të tjera dorëzoi raportin e prodhimit për vitin 2012 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2013 për ndërmarrjet e Trepçës që gjenden në Jug. Në të njëjtën datë me një parashtresë tjetër AKP-ja dorëzoi raportin e prodhimit për vitin 2012 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2013, për ndërmarrjet e Trepçës që gjenden në veri. Në seancën e datës 15 prill 2013, AKP ishte udhëzuar që të sjell raportet e prodhimit prej vitit 2011 e gjer më tanë për të gjitha ndërmarrjet e Trepçës.

AKP kësaj parashtrese i ka bashkëngjitur edhe disa dëshmi statistikore rrith nivelit të inflacionit në vend për periudhën tetor 2012-mars 2013, si raporte mujore (*Indeksi i Çmimeve të Konsumit*).

Arsyetim Ligjor:

Ngritja e pagave:

Në ndërmarrjet industriale, ngritja e pagave është e përshtatshme vetëm në dy raste, kur efikasiteti i punës ngritë – kur ka më shumë prodhim me numër të njëjtë të punëtorëve apo në rast të zhvlerësimit të theksueshëm të parasë. Argumenti kryesor i AKP-së ka qenë se dy Njësitë në fjalë – Stan Tërgu dhe Tuneli i Parë kanë pasur prodhim (performansë) më të mirë në vitin 2012 sesa në vitin 2011. Në seancën dëgjimore të datës 15 prill, gjykata i ka udhëzuar zyrtarët e AKP-së që të paraqesin statistikat e prodhimit të dy njësive për vitet 2011, 2012 dhe për tre muajt e parë të vitit 2013. Së bashku me analizat, Agjencia do të duhej të paraqiste analiza për arsyet e rënies/ngritjes në prodhimin e rregullt.

AKP-ja ka dorëzuar statistikat vetëm për vitin 2012 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2013, prandaj Agjencia ka dështuar në dorëzimin e dëshmive për të mbështetur kërkesën për ngritjen e pagave. AKP-ja ka dorëzuar dëshmi për shkallën e inflacionit për vitin 2012 –sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës shkalla e inflacionit është 3,6%. Megjithatë, gjykata nuk do ta miratoj një ngitje kompensimi në paga për vetëm një pjesë të punëtorëve. Agjencia nuk ka paraqitur as arsyë sociale dhe as ekonomike se pse vetëm një pjesë e punëtorëve të Ndërmarrjeve të Trepçës duhet të kompensohet për inflacion dhe pjesa tjetër të lihet anash.

Shqyrtimi i sistemeve të pagave:

Gjatë procedurës, gjykata e ka vënë re se zyrtarët e AKP-së kishin vetëm njohuri themelore dhe sipërfaqësore për sistemet e ndryshme të pagave për Ndërmarrjet e Trepçës. Zyrtarët e lartë të AKP-së e kanë pranuar në seancë dëgjimore se sistemet e pagave janë paraqitur nga ish-AKM-ja/UNMIK-u, shumë kohë para fillimit të procesit të riorganizimit dhe asnjëherë nuk janë

shqyrtuar nga AKP-ja pas marrjes së cilësisë së administratorit sipas ligjit të ri për riorganizim. Sistemi i pagave është ndër rregullat kryesore funksionale të çdo ndërmarrje dhe AKP-ja duhet të merr një rol më pro aktiv në krijimin e sistemit unik të pagave në përputhje me nevojat e ndërmarrjeve nën riorganizim. Gjykata konstaton se AKP-ja duhet të këshillohet për të rishikuar sistemet e pagave dhe të parashtroj raport në Dhomë, jo më vonë se gjëri më 31 korrik 2013.

Skema e Pensionimit të Parakohshëm:

Në parashtresën e datës 15 prill 2013, AKP ka specifikuar se Ndërmarrjet e Trepçës në vitin 2012 kanë paguar 3,005,390.00 €, për pagesat e “pensioneve të parakohshme” për 3055 përfitues dhe 136,150.00 €, pagesa për “stipendione” për 199 punëtorët e Ndërmarrjeve të Trepçës që gjenden në jug. Parashresa specifikon se sistemi i pensionimit të parakohshëm është krijuar sipas Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 2/2006 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për pensionim të parakohshëm për punëtorët e ndërmarrjeve të Trepçës. Nën disa kushte ky udhëzim ofron nga 50.00 €, kompensim mënyrë përfituesit në fjalë, mjetet financiare për këtë lloj pagesa duhet të vijnë nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Megjithatë, në parashtresën e datës 12 prill si dhe në parashtresën e datës 22 prill, AKP-ja në mënyrë eksplikite specifikon se një pjesë e pagesave është paguar nga mjetet financiare të Ndërmarrjeve të Trepçës. Të dy parashtresat specifikonin se shuma mënyrë përfituesit në fjalë, pagesat e këtilla – përderisa mbulohen nga të ardhurat e aktiviteteve të rregullta të biznesit – janë plotësisht pa bazë ligjore. Sipas udhëzimit në fjalë, Ndërmarrjet e Trepçës mund të ekzekutojnë pagesa për përfituesit e këtij sistemi, por paratë duhet të vijnë nga buxheti i shtetit. Prandaj në bazë të nenit 42.3 të Ligjit nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, gjykata urdhëron AKP-në të ndërpres menjëherë pagesat e këtilla joligjore.

Stipendite:

Sipas parashtresës së datës 15 prill 2013, Ndërmarrjet e Trepçës në Veri kanë paguar nga 30.00€, për muaj si “stipendione” në të holla për 1,873 persona dhe Ndërmarrjet në Jug i kanë paguar kontributin e njëjtë mënyrë përfituesit në fjalë, pagesat e këtilla – përderisa mbulohen nga të ardhurat e aktiviteteve të rregullta të biznesit – janë plotësisht pa bazë ligjore. Sipas udhëzimit në fjalë, Ndërmarrjet e Trepçës mund të ekzekutojnë pagesa për përfituesit e këtij sistemi, por paratë duhet të vijnë nga buxheti i shtetit apo organizata humanitare, por jo nga mjetet financiare të ndërmarrjeve të Trepçës. Të dy parashtresat specifikonin se shuma mënyrë përfituesit në fjalë, pagesat e këtilla – përderisa mbulohen nga të ardhurat e aktiviteteve të rregullta të biznesit – janë plotësisht pa bazë ligjore. Sipas udhëzimit në fjalë, Ndërmarrjet e Trepçës mund të ekzekutojnë pagesa për përfituesit e këtij sistemi, por paratë duhet të vijnë nga buxheti i shtetit. Prandaj në bazë të nenit 43.2 të Ligjit nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, prandaj gjykata urdhëron AKP-në që të ndërpres menjëherë pagesat e këtilla joligjore.

Personat që nuk janë marrë në konsideratë para kryerjes së pagesës në Veri

Në parashtresën origjinale, AKP shpjegon se ka harruar që të kérkoj aprovimin e një pjesë të fondit të pagave të punëtorëve për Ndërmarrjet e Trepçës në Veri. Çështja është sqaruar në parashtresën në fjalë si dhe në seancën dëgjimore të datës 11 prill. Për shkak të sistemit të pazakontë të pagave, deri në 10% e fondit të pagave duhet të llogaritet në fund të periudhës së

prodhimit, andaj lartësia e pagave nuk mund të dihet paraprakisht. Në tre muajt e parë të vitit 2013, një shumë prej 30,573.00 € është dashur t'i paguhet si shtesë këtyre punëtorëve, por kjo nuk është përfshirë në vendimin e gjykatës (C-V-13-0001, datë 1 shkurt 2013) për aprovimin e pagesës së rrogave. Këto çështje janë diskutuar nga Bordi i Drejtoreve të AKP-së më 10 prill 2013 dhe pagesa e 30,573.00 € është aprovuar. Prandaj, gjykata do të aprovojë këtë pagesë si një pjesë të pagesës së rregullt të pagave për punëtorët në këtë çështje.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtronet Apel brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Apeluesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon apelin si të papranueshëm nëse Apeluesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

Vladimir Kanev, gjyqtar kryesues

Sylejman Shumolli, gjyqtar

Ilmi Bajrami, gjyqtar
